



# Qëndrimet e serbëve të Kosovës ndaj institucioneve të sigurisë

Prill  
2021





Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

**Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë**

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

**Titulli i hulumtimit:** Qëndrimet e serbëve të Kosovës ndaj institucioneve të sigurisë

**Botues:** KFOS

**Për botuesin:** Qendra Humane Mitrovica  
(Humani centar Mitrovica)

**Autorët:** Srgjan Simonoviq, Verolub Petroniq

Gjuha origjinale në të cilën është punuar analiza është gjuha Serbe

**Përkthimi në gjuhën shqipe:** Xhenana Azizi

**Dizajni:** tedel

**Tirazhi:** 100

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatën Qendra Humane Mitrovica. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: 2021.



# PËRMBAJTJA

## 01.

HYRJE

7

## 02.

METODOLOGJIA

8

Metodologjia dhe modeli i  
hulumtimit sasior

5

Metodologjia dhe dizajni i  
kërkimit cilësor – Grupet e  
fokusit

5

Metodologjia dhe dizajni i  
kërkimit cilësor – intervistat

6

## 03.

GJETJET KYÇE

9

## 04.

KONTEKSTI  
HISTORIK I KUPTIMIT  
TË SIGURISË DHE  
MARRËDHËNIEVE  
ME INSTITUCIONET  
E SIGURISË NË  
KOSOVË

11

## 05.

REKOMANDIME

32

## 06.

BIBLIOGRAFIA

33

# Lista e akronimeve

- EULEX** → European Union Rule of Law Mission in Kosovo/Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
- HCM** → Qendra Humane Mitrovica
- KFOR** → Kosovo Force/Forca e Kosovës (Forcat Paqeruajtëse Ndërkombëtare në Kosovë)
- FSK** → Forca e Sigurisë së Kosovës
- PK** → Policia e Kosovës
- TMK** → Trupat Mbrojtëse të Kosovës
- KFOS** → Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
- KLSP** → Komiteti Lokal për Siguri publike
- IPK** → Inspektorati Policor i Kosovës
- UÇK** → Ushtria Çlirimtare e Kosovës
- OSBE** → Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
- IPK** → Inspektorati Policor i Kosovës
- UNMIK** → United Nations Interim Administration Mission in Kosovo/Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

# 1.Hyrje

Ky dokument u hartua si pjesë e iniciativës OPEN dhe përmbledh situatën aktuale rreth qëndrimeve të serbëve të Kosovës ndaj organizatave përgjegjëse për sigurinë në komunat me shumicë serbe dhe enklavat më të mëdha, kryesisht duke u përqendruar në Policinë e Kosovës. Paraqet gjendjen faktike dhe perceptimin e publikut kryesisht ndaj Policisë së Kosovës por edhe organizatave të tjera të sigurisë, duke marrë parasysh zhvillimet politike dhe frikën e

popullatës së këtyre komunave. Detyra kryesore e këtij dokumenti është t'i përgjigjet pyetjes se sa ndjenja e sigurisë ndikon në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës. Përveç kësaj, hartimi i këtij dokumenti analizon çështjet themelore të sigurisë së komunitetit serb të Kosovës, identifikon burimet e pasigurisë dhe ofron disa rekomandime për adresimin e çështjeve dhe sfidave të tilla nga perspektiva e komunitetit.

## 2. Metodologjia

Bazuar në hulumtimin voluminoz të realizuar nga ekipi i HCM në komunat me shumicë serbe në Kosovë dhe në enklavat më të mëdha serbe në komunat e tjera të Kosovës, ky punim përmes një studimi të literaturës dhe dokumentacionit të disponueshëm, një pyetësori, grupeve të fokusit dhe intervistave, ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të sfidave të sigurisë me të cilat përballet komuniteti serb në Kosovë. Pyetësori u realizua në një mostër prej 582 të anketuarve që banojnë në komunitetet serbe në Kosovë, duke trajtuar të dy gjinitë në mënyrë të barabartë. Grupet e fokusit u mbajtën me qytetarë në të dhjetë komunat me shumicë serbe, përfshirë anëtarët e komiteteve komunale të sigurisë. Intervistat u zhvilluan me komandantët e stacioneve policore në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq, Shtërpce, Partesh dhe drejtorin e policisë. Ekipi i HCM-së analizoi përmbajtjen e dokumenteve zyrtare, raportet ekzistuese si dhe rishikoi kornizat përkatëse ligjore. Gjetjet e përgjithshme u mbështetën nga vëzhgimi participativ dhe pjesëmarrje të ekipit të HCM-së në procese të ndryshme, si dhe në konsultime me palët përkatëse të interesit.

### Metodologjia dhe modeli i hulumtimit sasior

Anketimi ballë për ballë në terren u krye në periudhën nga 1 deri më 20 tetor 2020. Gjithsej 582 qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën. 50.5% e të anketuarve janë anketuar në jug të lumit Ibër, ndërsa 49.5% e të anketuarve janë anketuar në veri të lumit Ibër. Pyetësori përbëhej nga 65 pyetje dhe përfshinte gjithsej 8 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuotë, dhe kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës së të anketuarit. Intervali i besimit është +/- 5. Në mostër, kishte gjithsej 54.7% meshkuj dhe 45.3% femra. Moshë mesatare e të anketuarve është 44 vjeç. Me arsim fillor ishin 14.4% të të anketuarve, 62.1% me arsim të mesme dhe 23.5% me arsim të lartë, pra fakultet. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 25.9% janë të punësuar në sektorin publik, 22.3% në sektorin privat, 35.2% janë të papunë, ndërsa 16.6% janë në pension. Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës.



## Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor

### GRUPET E FOKUSIT

**Periudha:**

Hulumtimi u realizua nga muaji maj deri në dhjetor 2020

**Instrumenti i hulumtimit:**

Një udhëzues bisede i përbërë nga 4 fusha tematike dhe 28 pyetje

**Numri i grupeve të fokusit:**

**10** grupe të fokusit në 10 komuna me shumicë serbe

**Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:**

80 pjesëmarrës, nga 8 pjesëmarrës në secilin fokus grup, sipas gjinisë 49 meshkuj dhe 31 femra

**Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:**

Përfshirja në jetën socio-politike të komunitetit, me fokus çështjet e sigurisë

### INTERVISTAT

**Periudha:**

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor – intervistat

**Instrumenti i hulumtimit:**

Udhëzues për intervistë i përbërë nga 4 fusha tematike dhe 20 pyetje

**Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:**

**8** të intervistuar.

**Kriteret për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:**

Angazhimi profesional.

**Bashkëbiseduesit:**

Intervistat ballë për ballë realizuara me: Rashit Qalaj - Drejtor i Policisë së Kosovës, Komandant i Stacionit të Policisë Predrag Vasoviq nga Leposaviq, Komandant i Stacionit të Policisë Goran Zhivkoviq nga Mitrovica e Veriut, Komandant i Stacionit të Policisë Dragan Stefanoviq nga Zveçani, Kryetari i Komitetit të Sigurisë nga Zubin Potoku Srgjan Vuçeniq, Komandant i Stacionit Policor Dragan Ivanoviq nga Shtërpca, Komandant i Stacionit të Policisë Lubisha Periq nga Parteshi, Kryetari i Komitetit të Sigurisë Sasa Daniq nga Graçanica, Komandant i Stacionit të Policisë Zvezdan Spasojeviq nga Zubin Potoku.

## 3. Gjetjet kyçe

- Veprat penale më të zakonshme të kryera në komunat me shumicë serbe janë vjedhja, shkaktimi i lëndimeve të lehta dhe të rënda trupore, shkatërimi i pronës dhe dhuna në familje. Përqindja e rasteve të zgjidhura të veprave penale është shumë e ulët.
- Burimet kryesore të pasigurisë në mesin e komunitetit serb - sulmet e shpeshta ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb dhe pronës së tyre, shndërrimi i FSK-së në Ushtri të Kosovës dhe një numër i madh i veprave penale të pazgjidhura. Sulmet ndaj të kthyerve dhe pronës së tyre ndikojnë drejtpërdrejt në numrin e serbëve në Kosovë dhe në të drejtat e tyre themelore të njeriut.
- Niveli shumë i ulët i besimit në organizatat dhe institucionet përgjegjëse për sigurinë është pasojë e situatës së përgjithshme të sigurisë në të cilën gjendet komuniteti serb në Kosovë. Niveli më i lartë i besimit është te PK-ja, niveli më i ulët i besimit te FSK-ja.
- Korrupsioni, krimi i organizuar dhe narkotikët, si dhe krimi i rrugës, janë fenomenet që në masë më të madhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve serbë në Kosovë.
- Prania shumë e madhe fizike e pjesëtarëve të PK-së në rrugët e vendeve urbane, por efikasiteti shumë i dobët në parandalimin dhe reagimin pas kryerjes së veprave penale.
- Qytetarët kanë një qëndrim shumë negativ ndaj aktiviteteve të KP - nuk është neutrale në mbrojtjen e qytetarëve të nacionaliteteve të ndryshme, ka një shkallë të lartë të korrupsionit në të dhe nuk ka përmirësuar mbrojtjen e serbëve. Ekzistojnë disa dyshime se pjesëtarët e PK-së po marrin pjesë në aktivitete kriminale. Lidhur me cilësinë e mbrojtjes së manastireve serbe opinioni në mesin e komunitetit serb është i ndarë.
- Pengesat më të mëdha për punën e stacioneve policore në komunat me shumicë serbe janë mungesa e aseteve themelore, kryesisht vetura terreni, mjete teknike, para së gjithash kompjuterë, si dhe mungesa e përkthyesve, e cila në mënyrë të konsiderueshme pengon ose ngadalëson komunikimin në stacionet PK-së si me palët ashtu edhe me komandat rajonale dhe Drejtorinë.
- Elemente të dukshme të mungesës së lirisë së shprehjes, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje politike në komunitetet serbe në Kosovë.
- Masat për luftuar pandeminë Covid nuk ndikuan në situatën e sigurisë në komunat me shumicë serbe, edhe përkundër rritjes së aktivitetit të policisë. Numri i veprave penale të kryera është në nivelin e njëjtë si në periudhën para pandemisë, me një rritje të vullshme të numrit të rasteve të dhunës në familje.
- Ekzistenca e udhëzimeve të dyfishta nga Prishtina dhe Beogradi ka shkakuar konfuzion se cilat rregulla duhet të ndiqen. Qeveria e Kosovës në përgjithësi nga komuniteti serb vlerësohet pozitivisht në menaxhimin e krizës së shkakuar nga Covid.

## 4. Konteksti historik i kuptimit të sigurisë dhe marrëdhënieve me institucionet e sigurisë në Kosovë

Grupi më i madh i pakicave në Kosovë janë serbët. Regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 nuk u krye në veri të Kosovës kurse serbët që jetuan në jug e bojkotuan atë në masë. Sipas vlerësimeve nga të dhënat e OSBE-së të vitit 2010 dhe 2013, kishte 146,128 serbë që jetonin në Kosovë, duke përfaqësuar 7.8 përqind të popullsisë së përgjithshme - një përqindje shumë më e lartë se 1.5 e vlerësuar në regjistrimin e popullsisë të vitin 2011. Nga kjo, 70,430 serbë jetonin në veri, dhe 75,698 prej tyre në jug të Kosovës, në gjithsej 10 komuna në të cilat serbët përbëjnë shumicën.<sup>1</sup> Katër nga dhjetë komunat janë të vendosura në veri të Kosovës, përkatësisht Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi, ndërsa gjashtë komuna janë të vendosura në jug: Graçanica, Novobërda, Ranilugu, Parteshi, Klllokoti dhe Shtërpca. Një numër i konsiderueshëm i serbëve jetojnë në enklava (Gorazhdec, Osojan, Hoçë e Madhe ...) në komuna ku shqiptarët përbëjnë shumicën.

<sup>1</sup> [https://www.refworld.org/docid/49749cf70.html%20\[accessed%207](https://www.refworld.org/docid/49749cf70.html%20[accessed%207)

Pas përfundimit të konfliktit të vitit 1999 dhe kthimit të refugjatëve shqiptarë të dëbuar gjatë konfliktit, forcat ndërkombëtare kanë marrë përsipër paqeruajtjen dhe sigurimin e një mjedis të sigurt sipas Rezolutës 1244. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), një mision i Kombeve të Bashkuara i emëruar zyrtarisht në Kosovë, është mandatuar të asistojë Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në arritjen e qëllimit të përgjithshëm të sigurimit të kushteve për një jetë të qetë dhe normale për të gjithë njerëzit e Kosovës dhe promovimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor, duke marrë përgjegjësinë për territorin e Kosovës. Dy ditë pas nënshkrimit të Rezolutës 1244, paqeruajtësit ndërkombëtarë të udhëhequr nga NATO vijjnë në Kosovë për të krijuar një mjedis të sigurt për të gjithë. Sidoqoftë, ditët e para tregojnë se misioni nuk është në gjendje të përmbushë garancitë e sigurisë, duke rezultuar në zhvendosjen e 280,000 jo-shqiptarëve, kryesisht serbëve, në Serbinë qendrore<sup>2</sup>. Incidentet e përditshme u bënë rutinë dhe masakra në Grackën e

<sup>2</sup> <https://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/en/8929>

Vjetër (e njohur si vrasja e 14 korrësve serbë), më 23 korrik 1999, kur 14 serbë nga një fshat fqinj u vranë në atarin e fshatit Bujancë të Lipjanit, dhe autorët nuk u zbuluan dhe nuk u ndoqën penalisht, ishte një nga ngjarjet më të tmerrshme që la pasojë për brezat e ardhshëm. Në të njëjtën kohë, situata në katër komuna në veri të Kosovës është më e sigurt dhe pa viktima të shpeshta. Situata arriti kulmin në mars të vitit 2004, kur 19 persona humbën jetën në dhunën e motivuar etnikisht, 900 u plagosën, 29 kisha dhe manastire u rrënuan<sup>3</sup> dhe fshatrat e tërë u zhvendosën. Megjithatë më shumë se 50,000 njerëz morën pjesë në trazira, prokurorët ngritën procedurë ndaj vetëm 400 personave, nga të cilët shumë pak u ndoqën penalisht.<sup>4</sup> Meqenëse ata që kryejnë krime nuk janë sjellë para drejtësisë, besimi i publikut është shkelur dhe sundimi i ligjit është dobësuar. Duke parë gabimet, faktori ndërkombëtar ngriti nivelin e sigurisë në një nivel më të lartë, kështu që sulmet ndaj serbëve nuk po ndodhin në atë masë siç kanë ndodhur më parë. Numri i serbëve në Policinë e Kosovës po rritet, por kjo nuk ndikon në sigurinë themelore, kështu që pothuajse të gjitha fshatrat serbe preken nga vjedhjet e rënda të bagëtive dhe makinerive bujqësore. Grafitet me mbishkrime nënçmuese dhe parullat e UÇK-së ende shkruhen nëpër shtëpitë e pjesëtarëve të komunitetit serb. Në cak janë më shpesh vendbanimet e të kthyerve dhe enklavat e vetmuara, që paraqet një pengesë të pakapërcyeshme për kthimin e të dëbuarve në vitin 1999. Sipas Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, deri më sot në Kosovë janë kthyer rreth 28,500 qytetarë, duke përfshirë rreth 12,500 serbë. Për shkak të pengesave të sigurisë, zgjidhjes së ngadaltë të çështjeve të pronave të uzurpuara dhe situatës së dobët ekonomike, numri i të kthyerve po bie nga viti në vit.<sup>5</sup>

Me shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e serbëve të Kosovës, përfaqësimi i bashkësive etnike në PK është i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sigurohet me Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Ligjin Nr. 03/L-040 për

Vetëqeverisjen Lokale. Kushtetuta dhe Ligji për PK theksojnë se policia do të pasqyrojë larminë etnike të popullsisë së Kosovës dhe se zyrtarët policorë në komuna, për aq sa është e mundur, duhet të pasqyrojnë përbërjen etnike të komunës në fjalë. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale u garanton komunave, në të cilat komuniteti serb është shumicë, të drejtën ekskluzive për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantit të stacionit lokal të policisë.<sup>6</sup> Përkundër këtyre zgjidhjeve ligjore, të cilat sigurojnë përfaqësimin e serbëve në PK, shumë pjesëtarë të komunitetit serb po largohen nga PK në shenjë protestë.

Në fillim të vitit 2009, u formua Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), kryesisht nga pjesëtarët e atëherëshëm të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, e cila u bë plotësisht funksionale në 2013. Ky akt sjell trazira midis serbëve në Kosovë, por gjithashtu theksohet detyrim i qartë sipas të cilit trupat e FSK-së nuk mund të lëvizin në veri të lumit Ibër pa miratimin e komandantit të KFOR-it. Ky dokument u zbulua në Kuvendin e Kosovës 6 vjet më vonë. Për shkak të situatës së vështirë ekonomike, disa pjesëtarë të komunitetit serb po plotësojnë radhët e FSK-së, por në vitet e para ata ishin kryesisht nga enklavat e largëta. Më vonë, pjesëtarët e komunitetit serb nga komunat, madje edhe disa nga komunat veriore, u bashkuan me FSK-në, por 70 prej tyre, sipas Ministrisë të Mbrojtjes Rustem Berisha, u larguan nga FSK-ja për shkak të presioneve të ndryshme. Sipas Ministrisë Rustem Berisha, FSK aktualisht ka 54 anëtarë nga komuniteti serb, por sipas deklaratave të Berishës, ky numër mund të rritet, pasi FSK planifikon të rekrutojë pjesëtarë shtesë.<sup>7</sup>

Falë Marrëveshjes së Brukselit, institucionet serbe janë duke u integruar në kornizën legjislativë të Kosovës, kryesisht gjyqësorin, mbrojtjen civile dhe policinë. Pjesëtarët e policisë së Republikës së Serbisë, 285 prej tyre, janë integruar në Policinë e Kosovës. Integrimi i policisë është i rregulluar nga pikat 8, 9 dhe 10 të Marrëveshjes së Brukselit, ku thuhet se do të ketë një forcë të vetme policore në Kosovë të quajtur Policia e Kosovës. E gjithë policia në veri të Kosovës

3 <https://www.osce.org/files/f/documents/c/4/32701.pdf>

4 *ibid*

5 <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/617-svetski-dan-iz-beglica.html>

6 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 19.

7 <https://kossev.info/berisa-18-srba-napustilo-kbs-od-januar/>

do të integrohet në Policinë e Kosovës.<sup>8</sup> Mirëpo, edhe pse integrimi statistikor i qytetarëve serbë në PK ka qenë i suksesshëm, ai nuk pasqyron të njëjtin sukses në aspektin e perceptimeve publike dhe marrëdhënieve midis PK dhe komunitetit serb të Kosovës. Procesi i integritit të komunitetit serb të Kosovës ka qenë temë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe si i tillë, dialogu lokal mbi përfitimet dhe sfidat e përfshirjes së policisë është shmangur. Prandaj, pavarësisht hezitimit, shumica e tyre u bashkuan me PK pasi Beogradi i urdhëroi ta bënin këtë.<sup>9</sup>

Përkundër integritit të serbëve në PK, situata në terren mbetet e pandryshuar dhe numri i krimeve të kryera ndaj serbëve dhe pronës së tyre nuk po zvogëlohet. Edhe pse faktori ndërkombëtar, i mishëruar në EULEX, është i përfshirë në krijimin e një mjedisi të sigurt përmes mbikëqyrjes, trajnimit dhe këshillimit të Policisë së Kosovës, situata në terren mbetet e pandryshuar. Lidhja me qarqe kriminale e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, arrin kulmin me arrestimin e disa zyrtarëve policorë serbë, të cilët janë të përfshirë në vrasjen e Olliver Ivanoviqit. Konfuzioni shtesë shkaktohet nga deklaratat politike të liderëve të Serbisë, të cilët deklarojnë se ROSU nuk mund të ndërhyjë në veri të Kosovës pa pëlqimin e KFOR, gjë që shumë shpejt u mohua nga KFOR-i, duke specifikuar që vetëm FSK nuk mund të shkojë në veri të Kosovës pa miratimin e KFOR-it.<sup>10</sup>

Në dhjetor të vitit 2015 në veri të Kosovës u hap Zyra e Inspektoratit Policor të Kosovës, dhe menjëherë më pas rezultoi pezullimi i tetë zyrtarëve policorë nga veriu për pranimin e rryshfetit, dhe pakë më vonë pezullimi i një numri të zyrtarëve policorë të trafikut. Shqetësime shtesë paraqet miratimi i Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligjit për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes, që mundësojnë transformimin e FSK-së në Ushtri të Kosovës. Këto ligje u miratuan pa praninë e deputetëve serbë në parlament. Pasi që serbët e shohin FSK-në si pasardhëse të UÇK-së,

këtë fakt, të mbështetur nga mbishkrime kërcënuese nëpër shtëpi dhe billboard në vende publike, serbët e konsiderojnë si një faktor shumë shqetësues.

Se kërcënimet ndaj komunitetit serb nuk janë pjesë e së kaluarës tregojnë sulmet e vazhdueshme ndaj serbëve dhe pronave serbe, dështimi për të zgjidhur rastet e uzurpimit dhe sulmet ndaj të kthyerve, të cilat ndodhën edhe gjatë periudhës së masave për të luftuar Covid-in. Periudha e masave për të luftuar Covid-in karakterizohet nga konfuzioni fillestar i popullsisë së komunave me shumicë serbe, veçanërisht ato në veri, banorët e të cilave shpesh përzien masat e miratuara nga Republika e Serbisë me masat e miratuara nga Kosova.

## Përshkrimi i gjendjes dhe zbulimi i problemit

Qytetarët rreth situatës së sigurisë në Kosovë kryesisht informohen përmes mediave elektronike, më së shpeshti përmes televizioneve me frekuenca shtetërore në Republikën e Serbisë.<sup>11</sup> Kur bëhet fjalë për sigurinë në nivelin lokal, një pjesë e mirë e serbëve në Kosovë informohen përmes portaleve të internetit në Kosovë. Një pjesë e caktuar e komunitetit serb konsideron se informacioni është shumë i njëanshëm dhe se ata janë të privuar nga informacioni i vërtetë. Gjithashtu janë të mendimit se burimet e informacionit dhe mënyra e informimit luajnë një rol të madh në perceptimin e sigurisë së qytetarëve. Sipas mendimit të shumicës së pjesëmarrësve në grupe të fokusit, kërcënimet më të zakonshme me të cilat përballen serbët në Kosovë janë vjedhjet dhe rrahjet (sipas banorëve të komunave veriore), përkatësisht shkatërrimi i pronës dhe ngacmimet (nga këndvështrimi i të anketuarve nga komunat jugore). Sulmet e shpeshta, kryesisht ndaj vendbanimeve të personave të kthyer dhe enklavave në Kosovë, shihen si probleme thelbësore dhe identifikohen si një burim kryesor i pasigurisë. Shumica e popullatës serbe i kupton këto sulme si një mesazh për komunitetin serb dhe si një demonstrim të fuqisë, por ka gjithashtu mendime se prapa sulmeve të tilla

8 <https://www.srbija.gov.rs/cinjenice/en/120394>

9 [http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community\\_KosovoPolice-srb\\_\(1\)\\_633305.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community_KosovoPolice-srb_(1)_633305.pdf)

10 <https://www.vesti.rs/Kosovo/ROSU-moze-bez-dozvole-Kfora-na-sever-Kosova-ali-KBS-ne-2.html>

11 Grupet e fokusit me komunitetin serb në 10 komuna me shumicë serbe

fshihet agjenda politike.<sup>12</sup> Nga shkurti deri në qershor të vitit 2020, kishte 26 sulme të vazhdueshme ndaj të kthyerve.<sup>13</sup> Lloje të ndryshme presioni dhe shantazhi shpesh i shtynjë Serbët falas të ua japin tokën uzurpatorëve, në mënyrë që të fitojnë paqen, mirëpo ata shpesh përfundojnë të rrahur ose fizikisht të dëmtuar.<sup>14</sup> Një shqetësim shtesë është shkaktuar nga fakti se pavarësisht masave të kontrollit të rritura për shkak të pandemisë Covid dhe pranisë së shtuar të policisë, numri i sulmeve ndaj të kthyerve dhe pronës së tyre është ende në rritje. Cak i sulmit nuk janë vetëm të kthyerit dhe prona e tyre, por edhe serbët që jetojnë në enklava.

Transformimi i FSK-së në Ushtri të Kosovës shihet si një burim tjetër i pasigurisë në komunitet, të cilin serbët në Kosovë më së shumti e perceptojnë si një formacion armiqësor, përkundër faktit që në përbërje ka 54 pjesëtarë të komunitetit serb.<sup>15</sup> Ekziston një farë frike se një instrument i tillë i forcës mund të përdoret kundër komunitetit serb. Mendimi i pjesëmarrësve është që një numër i caktuar i serbëve që janë aktualisht në TMK janë për arsye ekzistenciale dhe largohen nga TMK sapo të krijohet mundësia për një punë tjetër. Këtij qëndrimi i kontribuon gjithashtu fakti që ndërtesat e pjesëtarëve të komunitetit serb shpesh rrënohen dhe përmbajnë mbishkrime që glorifikojnë UÇK-në, gjë e cila rezulton në shkaktimin e frikës dhe një atmosferë tensioni.<sup>16</sup>

Numri i veprave penale të kryera në komunat me shumicë serbe tregon se situata nuk është më e mira. Sipas të dhënave të policisë, të marra në bazë të kërkesës për qasje në informacione publike, në tabelën më poshtë mund të shohim se cilat incidente ndodhin më shpesh në komunat me shumicë serbe. U morën parasysh veprat e kryera nga janari deri në nëntor 2020. Tabela nuk përmban incidente që përsëriten më pak se 3 herë:

<sup>12</sup> Ibid

<sup>13</sup> <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/615-nastavljaju-se-incidenti-na-srbe-povratnike.html>

<sup>14</sup> <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/589-kontinuirani-na-papadi-na-povratnike-u-istoku-i-klini-pogor%C5%A1ali-bez-bednosnu-situaciju.html>

<sup>15</sup> <https://kossev.info/berisa-18-srba-napustilo-kbs-od-januar-ara/>

<sup>16</sup> <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/578-srspka-%C5%A1kola-u-gojbulji-kod-vu%C4%8Ditna-na-meti-vandala.html>

**Tabela 1.** Statusi i veprave penale më të shpeshta

| Veprat e kryera                        | Mitrovica e Veriut | Zveçan |
|--|--------------------|--------|
| Vjedhje                                | 47                 | 24     |
| Lëndime fizike                         | 32                 | 4      |
| Dhuna në familje                       | 20                 | 5      |
| Vrasje në tentativë, vdekje e dyshimtë | 4                  | 0      |
| Mosrespektimi i udhëzimeve mjekësore   | 5                  | 5      |
| Shkatërrim dhe dëmtim i pronës         | 13                 | 5      |
| Kërcënim ose ngacim                    | 12                 | 4      |
| Sulm                                   | 7                  | 2      |
| Pengimi i personit zyrtar              | 5                  | 2      |
| Prishja e rendit dhe qetësisë publike  | 3                  | 7      |
| Rrezikim i sigurisë                    | 14                 | 7      |
| Zjarrvënia                             | 1                  | 0      |
| Grabitje                               | 3                  | 0      |
| Posedimi i paautorizuar                | 2                  | 1      |
| Falsifikimi i dokumenteve              | 1                  | 3      |
| Tentim për dhunim dhe dhunim           | 1                  | 0      |
| Transportimi i kundërligjshëm i drurit | 0                  | 5      |

**Komunat në total**

**Mitrovica e Veriut**

**Zveçan**

**172**

**76**

| Zubin Potok | Leposaviq | Graçanicë | Shtërpcë | Ranillug | Novobërdë | Partesh | Kllokot | Në total |
|-------------|-----------|-----------|----------|----------|-----------|---------|---------|----------|
|             | 27        | 56        | 8        | 3        | 23        | 5       | 1       | 227      |
| 11          | 11        | 20        | 12       | 4        | 2         | 0       | 7       | 103      |
| 2           | 12        | 12        | 5        | 3        | 2         | 1       | 5       | 67       |
| 2           | 0         | 2         | 0        | 2        | 0         | 1       | 1       | 12       |
| 3           | 9         | 1         | 3        | 1        | 0         | 0       | 0       | 28       |
| 4           | 15        | 18        | 13       | 1        | 9         | 2       | 1       | 81       |
| 6           | 15        | 16        | 4        | 1        | 1         | 1       | 4       | 64       |
| 8           | 18        | 5         | 3        | 2        | 4         | 1       | 2       | 52       |
| 1           | 8         | 1         | 0        | 1        | 1         | 1       | 0       | 20       |
| 14          | 2         | 3         | 1        | 0        | 2         | 2       | 0       | 34       |
| 3           | 3         | 0         | 2        | 1        | 0         | 1       | 0       | 31       |
| 1           | 2         | 1         | 1        | 1        | 0         | 0       | 1       | 8        |
| 1           | 6         | 1         | 0        | 0        | 0         | 0       | 0       | 11       |
| 5           | 3         | 5         | 0        | 0        | 0         | 0       | 0       | 16       |
| 2           | 8         | 4         | 4        | 0        | 0         | 0       | 2       | 24       |
| 0           | 1         | 4         | 0        | 1        | 0         | 0       | 1       | 8        |
| 0           | 0         | 0         | 0        | 0        | 0         | 0       | 0       | 5        |

Zubin Potok    Leposaviq    Graçanica    Shtërpcë    Ranillug    Novobërdë    Partesh    Kllokot

**98            146            163            57            26            46            16            27            827**


Të dhënat nga tabela janë marrë në bazë të kërkesës për qasje në informacione publike - Drejtoria e Policisë së Kosovës - të dhënat për veprat e kryera në tabelë janë kumulative, kështu që vjedhjet përfshijnë vjedhje të rënda, vjedhje të lehta, grabitje, etj., dëmtimet trupore përfshijnë dëmtime të lehta dhe të rënda, etj.

Nga tabela e bashkangjitur mund të shohim se popullata në komuna me shumicë serbe preket më shpesh nga vjedhjet (227 gjithsej), pastaj nga lëndimet trupore (103), shkatërimi i pronës (83), dhuna në familje (60), kërcënimet dhe ngacmimet (60), ndërsa kryerja e veprave tjera penale nuk është aq e shpeshtë. Tabela tregon qartë se numri i veprave penale të kryera varet nga madhësia e komunës, kështu që numri më i madh i veprave është kryer në Mitrovicën e Veriut dhe Graçanicë, si dy komunitet më të populluara me shumicë serbe. Duhet të theksohet se ky rishikim nuk tregon veprime dhe incidente të kryera ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb që jetojnë në enklava të izoluar në komuna të tjera, por situata në të cilën banorët e këtyre enklavave gjenden shtrihet në pjesë të tjera, duke ndikuar në ndjenjën e sigurisë tek i gjithë komunitetit serb. Gjithashtu, nga tabela e bashkangjitur shihet qartë se masat e paraqitura gjatë pandemisë në komunitet me shumicë serbe nuk kanë ndikuar në numrin e veprave penale, që janë edhe vlerësimet e komandantëve të stacioneve policore kur

bëhet fjalë për lëvizjen e nivelit të krimit.<sup>17</sup> Ka pasur një rritje të dhunës në familje, veçanërisht gjatë periudhës së masave kundër pandemisë Covid dhe kufizimeve të lëvizjes. PK, si organ përgjegjës për sigurimin e masave mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje, ka krijuar marrëdhënie me strehimoren rajonale (Shtëpinë e Sigurt), e cila kohët e fundit ka filluar punën në Zupçë, vendbanim në Zubin Potok.<sup>18</sup> Mosrespektimi i masave shëndetësore është një vepër që nuk ka ndodhur më parë në komunitet me shumicë serbe, por komandantët e stacioneve të policisë pajtohen që këto vepra janë sigurisht në numër shumë më të madh dhe se policia është jashtëzakonisht tolerante kur bëhet fjalë për vepra të tilla.

Se efikasiteti i policisë si një instrument themelor për rritjen e besimit tek qytetarët nuk është aspak i madh, mund të shihet nga diagrami vijues i cili tregon numrin e veprave të kryera dhe numrin e rasteve të zgjidhura për veprat më të shpeshtë të kryera.

**Grafiku 1.** Raporti në mes të veprave penale totale të kryera dhe rasteve të zgjidhura



Të dhënat e marra në bazë të kërkesës për qasje në informacione publike.

<sup>17</sup> Intervista me komandantët e stacioneve të policisë.

<sup>18</sup> <https://www.kosovo-online.com/vesti/drustvo/otvorena-sigurna-kuca-u-zubinom-potoku-29-6-2020>



**Tabela 2.** Statusi i veprave penale më të shpeshta

| Statusi                      | Kërcënime | Vjedhje | Sulme | Shkatërrim i pronës | Shkaktimi i lëndimeve trupore |
|------------------------------|-----------|---------|-------|---------------------|-------------------------------|
| Rastet në total              | 64        | 227     | 52    | 81                  | 103                           |
| Të zgjidhura                 | 7         | 9       | 7     | 3                   | 11                            |
| Kallëzime penale të ngritura | 11        | 6       | 4     | 2                   | 5                             |
| Dorëzuar prokurorit          | 15        | 5       | 16    | 11                  | 42                            |
| Nën hetim                    | 29        | 169     | 13    | 56                  | 36                            |

Të dhënat e marra në bazë të kërkesës për qasje në informacione publike.

Vetëm shtatë nga 64 rastet e kërcënimit janë zgjidhur. Kur bëhet fjalë për vjedhje, duhet të theksohet se nga një total prej 227 rasteve, vetëm 9 janë zgjidhur - 169 raste janë ende nën hetim, 5 raste janë dorëzuar në prokurori dhe janë ngritur 6 kallëzime penale. Kur bëhet fjalë për sulme, nga gjithsej 52 sulme u zgjidhën 7, 4 kallëzime penale u ngritën, 16 raste u dorëzuar në prokurori të shtetit dhe 13 janë ende nën hetim.

Që policia është në dijeni të nivelit të ulët të besimit të qytetarëve në punën e saj tregon fakti se gjashtë nga shtatë komandantë të stacioneve policore të intervistuar besojnë se niveli i besimit tek policia është nën 50%, që paraqet një vetëvlerësim që sipas mendimit të tyre tregon nevojën për ngritjen e mëtejshme të besimit në Policinë e Kosovës. Për hir të së vërtetës, komandantët e stacioneve policore deklarojnë se qytetarët shpesh raportojnë raste që nuk mund të trajtohen nga policia, gjë që tregon se hapja e komunitetit serb ndaj policisë po rritet.

Kur bëhet fjalë për raportin që qytetarët e komunave me shumicë serbe kanë ndaj PK-së, është e nevojshme të theksohet se qytetarët janë të vetëdijshëm që institucioni i PK-së është parësor në sigurimin e një mjedisi të sigurt. PK-ja ka stacione

dhe degë të veta në të gjitha komunat dhe enklavat më të mëdha. Pjesëmarrja e qytetarëve serbë në PK është 12%. Ajo që i mungon PK-së është sigurisht barazia gjinore, kështu që në komunat që ishin objekt i këtij hulumtimi, përqindja e grave në PK është 11%, krahasuar me përqindjen në nivelin e Kosovës prej 14.15%. Sipas zyrtarëve të intervistuar të PK-së, rritja e numrit të grave do të reflektonte në përmirësimin e cilësisë së punës, dhe kjo do të ishte shumë e dukshme në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Përmes programit "Policia e Komunitetit" parashikohet që me propozimin e komunitetit të tyre dhe Komandantit të Stacionit, dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të krijohen Komitete Lokale të Sigurisë Publike, dhe kështu të vendosen marrëdhënie me komunitetin; kjo është bërë, dhe është krijuar bashkëpunimi më i mirë me komunitetin. Nga ana tjetër, komunat me shumicë serbe, me ndihmën e OSBE-së, kanë filluar krijimin e Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP). Anëtarët e KLSP kanë kaluar përmes programit të OSBE-së për ndërtimin e kapaciteteve. Këto KLSP në komuna veriore, më saktësisht në komunën e Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit, e kanë identifikuar problemin e qenve endacak si një nga prioritetet më të larta. Gjegjësisht, sipas pretendimeve të anëtarëve të KLSP-së nga

Zveçani, qentë endacak shpesh sillen me furgona dhe lirohen në territorin e Zveçanit. Në këtë rast, zgjidhja e problemit nuk mund të kërkohej nga PK, por duhet të zgjidhet në mënyrë sistematike, dhe deri atëherë është e sigurt që paraqet një problem të madh për banorët e këtyre komunave. Në përgjithësi, krijimi i KLSP-ve dhe prania e përfaqësuesve të policisë në takimet e tyre kontribuon në rritjen e nivelit të besimit në PK, por që nuk është afër me nivelin e besimit që PK gëzon në komunat e tjera. Pengesa kryesore në punën e KLPS-ve është se ata reflektohen kryesisht në parimin e pjesëmarrjes vullnetare, pa kompensim financiar, mungesë fondesh për projekte dhe pjesëmarrje të pabarabartë të grave në to.

Problemi i përkthimit është një pengesë kryesore për efikasitetin e punës së policisë, sepse, siç pretendojnë komandantët e intervistuar, përkthimi nga niveli qendror në atë lokal vonohet për disa ditë, gjë që reflektohet në punën e policisë në terren. Stacionet e policisë nuk kanë të punësuar një përkthyes, gjë që shpesh është një problem. Komanda Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Veriut ka në dispozicion vetëm një përkthyes, i cili për shkak të vëllimit të punës nuk mund të sigurojë mbështetjen e duhur për stacionet lokale të policisë.<sup>19</sup> Kur bëhet fjalë për perceptimet e përgjithshme të sigurisë, vlerësimi i komandantit është se siguria e komunitetit është e lidhur ngushtë me marrëdhëniet e politikanëve lokalë me autoritetet qendrore në Prishtinë, në kuptimin që marrëdhëniet më të mira çojnë në një situatë më të mirë të sigurisë. Një problem i rëndësishëm në punën e policisë është mungesa e veturave të terrenit që do të mundësohet arritjen në zonat e prekura në një periudhë të shkurtër kohe, duke marrë parasysh që një numër i madh i veprave kryhen në zonat rurale. Mos testimi i zyrtarëve të punësuar të policisë për Covid 19 është gjithashtu një problem, përveç në rastet kur shfaqen simptoma të rënda; numri i maskave dhe dorezave mbrojtëse është shumë i vogël, kështu që vetë komandantët kërkojnë zgjidhje përmes donacioneve.<sup>20</sup>

19 Intervista me komandantët e stacioneve të policisë. dhe dorezave mbrojtëse është shumë i vogël, kështu që vetë komandantët kërkojnë zgjidhje përmes donacioneve.

20 Ibid.

Sipas komandantëve të stacioneve të policisë, marrëdhëniet me Drejtorinë dhe IPK-në janë mjaft të mira, dhe ekziston një bashkëpunim i dyanshëm, por është e qartë se mungesa e fondeve në nivelin qendror reflektohet në ato lokale, kështu që pajisja e stacioneve lokale të policisë kufizohet në fondet më themelore.


Konkluzioni i shumicës në grupe të fokusit është prezenca e madhe dhe efikasitet i vogël; jepet shembulli i Zveçanit, ku PK kontrollon 3 deri 4 herë rrugën prej tre kilometrash (kësaj duhet shtuar mundësinë e kontrollit nga policia e trafikut nëse është në pyetje shoferi), por efektet e punës nuk përmirësohen dhe numri i veprave penale nuk po zvogëlohet. Një shembull në Mitrovicën e Veriut, ku një numër i madh i anëtarëve të PK-së mund të shihen çdo ditë në qendër të qytetit, por asnjë nga pjesëtarët e PK-së nuk gjendet në disa pjesë problematike të qytetit. Mungesa e reagimit të disa pjesëtarëve të PK-së ndaj rrahjeve masive, dhe bazuar në autoritetin e tyre për të ruajtur rendin dhe paqen publike, që kanë ndodhur në Mitrovicën e Veriut, është gjithashtu karakteristikë e këtij qyteti si mjedis më urban serb në Kosovë. Ky përfundim u konfirmua nga pezullimi i 6 zyrtarëve policorë nga IPK-ja.<sup>21</sup>

Megjithëse ekziston besim i konsiderueshëm se policia është e përfshirë në praktika të ndryshme korruptive, konkluzionet nga grupet e fokusit janë që policia nuk është e përfshirë në procesin zgjedhor, përveç në nivelin e kërkuar nga ligji. Duke marrë parasysh raportin e vëzhguesve të BE-së mbi zgjedhjet në Kosovë, i cili, ndër të tjera, thotë që fushata ishte konkurruese, përveç në zonat serbe të Kosovës ku mjedisi i fushatës u shënua nga frikësimi i kandidatëve dhe mbështetësve të cilët nuk ishin nga radhët e Listës Serbe.<sup>22</sup> Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit të mbajtura në komunat me shumicë serbe në Kosovë besojnë se policia nuk ishte e përfshirë në procesin zgjedhor, por nuk bëri asgjë për të parandaluar dukuri të tilla.

21 <https://kossev.info/pik-zbog-jucerasnje-tuce-u-mitrovici-suspendovano-sest-policajaca-jedan-ima-cin-kapetana/>

22 <https://kossev.info/pik-zbog-jucerasnje-tuce-u-mitrovici-suspendovano-sest-policajaca-jedan-ima-cin-kapetana/>

**Grafiku 2.** Në Kosovë në 12 muajt e fundit situata është shumë më e mirë, pak më e mirë, mbeti e njëjtë, pak më e rëndë, ose dukshëm u rëndua



Rezultatet e anketës së realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Një kërcënim i mundshëm i sigurisë u ngrit gjatë zbatimit të ndihmës së pakos së aprovuar nga qeveria e Kosovës për të papunët. Për atë qëllim, në Mitrovicën e Veriut u caktua një zyrë për pagesën e ndihmës financiare për banorët e 4 komunave veriore, e cila shkaktoi një turmë të madhe dhe paraqiste një rrezik të mundshëm për përhapjen e pandemisë. Pjesëmarrësit në fokus grupet e komunave në veri pajtohen që policia bëri një punë mjaft të mirë për të mbajtur rendin gjatë kësaj ngjarje e cila zgjati për disa ditë.


Kur bëhet fjalë për vlerësimin e situatës së sigurisë në Kosovë, detyra e të anketuarve ishte të vlerësonin situatën e sigurisë në Kosovë gjatë vitit të kaluar në një shkallë prej 1 deri në 5 krahasuar me periudhën e mëparshme. Rezultatet janë paraqitur në Grafikon 2.

Siç tregon grafiku, situata e sigurisë në vitin e fundit vlerësohet nga qytetarët e komunitetit serb në Kosovë si e pandryshuar në krahasim me vitin paraprak, që përputhet me të dhënat për shkallën dhe numrin e veprave të kryera<sup>23</sup> dhe opinionet e zyrtarëve të intervistuar të policisë. Ndryshimi i vetëm, dhe atë në kuptimin negativ, është rritja e numrit të rasteve të dhunës në familje<sup>24</sup>, ndërsa shumica e të anketuarve vlerësojnë se situata e sigurisë është e njëjtë me vitet e mëparshme. Megjithatë, ka një ndryshim të rëndësishëm në perceptimin e sigurisë në 12 muajt e fundit në lidhje me vendbanimin veri-jug, siç mund të shihet në grafikun në vijim:

23 Faqe 11

24 ibid

**Grafiku 3.** Në Kosovë në 12 muajt e fundit sipas vendbanimit situata është shumë më e mirë, pak më e mirë, mbeti e njëjtë, pak më e rëndë, ose dukshëm u rëndua




Nga grafiku shihet se 10.7% e të anketuarve nga veriu i Kosovës mendojnë se situata e sigurisë është shumë më e rënduar, ndërsa kjo përqindje është shumë më e lartë në mesin e të anketuarve në komunat jugore dhe arrin në 28.6%. Duke pasur parasysh që numri i veprave penale është mjaft i ekuilibruar kur bëhet fjalë për ndarjen gjeografike në veri dhe jug të Kosovës, mund të konstatohet se ky mendim është rezultat i një numri të shtuar të sulmeve ndaj të kthyerve dhe pronës së tyre në 12 muajt e fundit, pasi që të gjitha vendet e kthimit janë në jug të Kosovës.

Kur u pyetën se sa popullsia u beson institucioneve të caktuara të sigurisë në Kosovë, detyra e të anketuarve ishte të vlerësonin në një shkallë prej një deri në pesë se sa u besojnë institucioneve të sigurisë të tilla si Policia e Kosovës, EULEX, KFOR dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Rezultatet janë paraqitur në Grafikon 4.

Kur bëhet fjalë për besimin në institucionet e sigurisë në Kosovë, mund të shihet se niveli i besimit të plotë është shumë i ulët, dhe se serbët në Kosovë kryesisht nuk kanë, ose fare nuk kanë

**Grafiku 4.** Sa u besoni institucioneve të mëposhtme të sigurisë në Kosovëvu



Rezultatet e anketës së realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

besim në institucionet e sigurisë. Në kategorinë e besimit absolut, PK zë pozicionin më të mirë me 3.9% të të anketuarve që besojnë plotësisht në PK, ndërsa 2.5% e të anketuarve i besojnë plotësisht KFOR-it. Të anketuarit më së shumti i besojnë PK-së (37.3%). Interesante, në mesin e të anketuarve që më së shumti i besojnë Policisë së Kosovës (37.3% të numrit të përgjithshëm të të anketuarve), 31.80% e tyre jetojnë në komunitat jugore dhe 43% në veri, që është një hap i rëndësishëm përpara në krahasim nga hulumtimet e mëparshëm <sup>25</sup>. Përkundër komunave me

shumicë shqiptare, ku niveli më i lartë i besimit është te FSK-ja<sup>26</sup>, në mesin komunitetin serb këto forca kanë nivelin më të ulët të besimit. Rrënjët e mosbesimit duhet të kërkohen në faktin se FSK-ja ka origjinën nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të cilat, nga ana tjetër, kanë origjinën nga veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Niveli i besimit te EULEX-i është i ulët dhe nuk ka ndryshuar dukshëm në krahasim me periudhën e mëparshme.


25 [http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community\\_KosovoPolice-srb\\_\(1\)\\_633305.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community_KosovoPolice-srb_(1)_633305.pdf)

26 [http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community\\_KosovoPolice-srb\\_\(1\)\\_633305.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community_KosovoPolice-srb_(1)_633305.pdf)

Në mënyrë që të identifikohen fenomene të caktuara që mund të jenë thelbësore për të rrezikuar situatën e sigurisë në Kosovë është ofruar një grup prej 8 dukurish. Detyra e të anketuarve ishte të

vlërësonin në një shkallë prej një deri në pesë se sa kërcënuese është secila prej dukurive të ofruara. Rezultatet janë paraqitur në Grafikonin 5.

**Grafiku 5.** Sa këto dukuri kërcënojnë sigurinë e qytetarëve serbë në Kosovë



Rezultatet e anketës së realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Nga grafiku mund të shihet se dukuria që më së shumti ndikon në siguri është korrupsioni, i ndjekur nga krimi i organizuar dhe narkotikët. Edhe pse numri më i madh i veprave janë kryer në fushën e krimit të rrugës (vjedhje, shkaktim i lëndimeve dhe akte të tjera)<sup>27</sup>, të anketuarit e identifikojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar si fenomene apo dukuri shumë të ngulitura në të gjitha sferat e jetës shoqërore, të cilat, si të tilla, ndikojnë në mënyrë direkte dhe indirekte në nivelin e sigurisë së komunitetit. Korrupsioni, nga qytetarët e Kosovës, njihet si rreziku më i madh i brendshëm<sup>28</sup>, dhe raporti i

Komisionit Evropian për Kosovën veçanërisht në këtë kuptim thekson veriun e Kosovës, duke e vlerësuar situatën në këtë territor si sfiduese, veçanërisht kur bëhet fjalë për korrupsionin, krimin e organizuar dhe lirinë e shprehjes.<sup>29</sup>

Në tabelën në vijim, mund të shohim se si të anketuarit nga veriu dhe jugu i Kosovës perceptojnë incidentet të caktuara në lidhje me kërcënimet e sigurisë, duke i vlerësuar ato në një shkallë nga një në deri në pesë, ku 1 d.m.th. nuk është aspak kërcënues ndërsa 5 është shumë kërcënues.

**Tabela 3.** Incidentet që kërcënojnë sigurinë sipas shtrirjes gjeografike

| Incidentet                         | Zona gjeografike                              | 1    | 2    | 3    | 4    | 5    | Pa përgjigje |
|------------------------------------|---|------|------|------|------|------|--------------|
| Krimi i rrugës (vjedhje, grabitje) | Kosova e Veriut                               | 1,1  | 5,9  | 4,3  | 55,6 | 32,5 | 0,5          |
|                                    | Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër | 3,9  | 5,3  | 6,6  | 30   | 53,6 | 0,6          |
| Narkotikët                         | Kosova e Veriut                               | 0,2  | 6,2  | 2,6  | 40,4 | 45,7 | 5            |
|                                    | Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër | 5,6  | 9,1  | 5,2  | 31,7 | 47,1 | 1,3          |
| Krimi i organizuar                 | Kosova e Veriut                               | 0    | 4,5  | 3    | 35,6 | 41,3 | 15,7         |
|                                    | Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër | 2,3  | 8    | 6,1  | 36,8 | 45,4 | 1,4          |
| Korrupsioni                        | Kosova e Veriut                               | 1,7  | 3,5  | 5,5  | 29,2 | 43,8 | 16,2         |
|                                    | Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër | 4,3  | 4,8  | 3,5  | 31,3 | 55,5 | 0,6          |
| Incidentet ndëretnike              | Kosova e Veriut                               | 0,6  | 11,7 | 12,9 | 29,1 | 33,2 | 12,5         |
|                                    | Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër | 4,7  | 10,7 | 8,9  | 30   | 45,6 | 0,2          |
| Dhuna e motivuar politikisht       | Kosova e Veriut                               | 1,5  | 11,4 | 15,9 | 27   | 33,3 | 10,9         |
|                                    | Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër | 6,5  | 14,1 | 10   | 27,4 | 41,7 | 0,3          |
| Trafikimi me njerëz                | Kosova e Veriut                               | 4,7  | 16,6 | 22,6 | 23,7 | 29,9 | 2,4          |
|                                    | Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër | 15,6 | 19,9 | 6,3  | 20,4 | 35,5 | 2,2          |
| Prostitucioni                      | Kosova e Veriut                               | 12,7 | 23,6 | 14,8 | 23,2 | 24,1 | 1,6          |
|                                    |   | 16,6 | 25,8 | 4,8  | 21,7 | 29,1 | 2            |

1 – aspak kërcënues; 2 – kryesisht jo kërcënues; 3 – neutral; 4 – kryesisht kërcënues; 5 – shumë kërcënues; NO – pa përgjigje; vlerat janë të shprehura në përqindje

Rezultatet e anketës së realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

27 Tabela 2 e këtij raporti.  
28 Barometri Kosovar i Sigurisë.

29 <https://europeanwesternbalkans.com/2020/10/06/key-findings-of-the-2020-european-commission-report-on-kosovo/>


Nga Tabela 3, mund të konstatojmë se perceptimi i të anketuarve në veri në lidhje me korrupsionin është i ndryshëm në krahasim me perceptimin e këtij problemi nga të anketuarit në komunat në jug. Përqindja e të anketuarve nga komunat në jug që e shohin korrupsionin si shumë të dëmshëm është 55.5, ndërsa në veri është 43.8.

Këtu duhet të merret parasysh që nocioni i korrupsionit më së shpeshti lidhet me ngjarjet politike dhe organet shtetërore, kështu që ky rezultat mund të lidhet me mungesën e lirisë së shprehjes dhe ngurrimin e të anketuarve nga veriu për të shprehur mendimin e tyre për çështje në lidhje me jetën politike që drejtpërdrejtë ndikojnë në sigurinë e komunitetit. Një ndryshim i dukshëm ekziston në raste të incidenteve ndëretnike, ku të anketuarit nga komunat në jug besojnë se incidentet ndëretnike janë shumë të dëmshme për sigurinë (45.6%), ndërsa në veri ajo përqindja është 33.2, që ndërlidhet me mjedisin në të cilin jetojnë banorët e komunave në jug. Ekziston një ndryshim i dukshëm në shfaqjen e krimit të rrugës, ku banorët e komunave në jug e konsiderojnë krimin e rrugës shumë të dëmshëm në përqindjen prej 53.6, ndërsa në veri përqindja është 32.5.

Këtu duhet të kemi parasysh pakënaqësinë e banorëve të Graçanicës për shkak të numrit të madh të vjedhjeve që po ndodhin në atë komunë. Grupi i katërt i pyetjeve në këtë pjesë të anketës kishte të bënte me verifikimin e qëndrimeve të caktuara ndaj Policisë së Kosovës. Të anketuarve iu dha detyra të vlerësojnë në një shkallë prej 1 deri në 5 se sa pajtohen me 7 pretendimet dhëna.


Mospajtimi i të anketuarve me qëndrimin se PK mbron në mënyrë të barabartë serbët dhe shqiptarët është i dukshëm. 26.3% e të anketuarve aspak nuk pajtohen me këtë pretendim, 42.6% nuk pajtohen, 10.8% nuk kanë mendim rreth kësaj pyetjeje, 16.5% pajtohen dhe 2.6% plotësisht pajtohen, përderisa 1.2% e tyre nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje. Qëndrimet janë mjaft të ekuilibruara kur bëhet fjalë për ndarjen gjeografike në veri dhe jug të Kosovës, statusin martesor, gjininë dhe moshën e të anketuarve. Ky mendim kryesisht kontribuohet nga një numër i madh i veprave potencialisht etnikisht të motivuara, të tilla si sulmet ndaj të kthyerve dhe shkatërrimi i pronës së tyre, dhe mos identifikimi i autorëve që rrënuan kulturën materiale serbe, ku përfshihen kisha, manastire dhe varreza.

**Grafiku 6.** PK mbron në mënyrë të barabartë shqiptarët dhe serbët






**Grafiku 7.** Ekziston një nivel i lartë i korrupsionit në PK



Rezultati ankete izvrshene u sklopu inicijative OPEN

Siç paraqitet në Grafikon 7, 21.1% pajtohen plotësisht me pretendimin se ekziston një nivel i lartë i korrupsionit në PK, ndërsa 41.4% pajtohen me këtë pretendim, 14.8% e tyre nuk kanë mendim për të, 11.9% nuk pajtohen me këtë pretendim, ndërsa 1.5% nuk pajtohen aspak. Është mjaft e qartë se një numër shumë i vogël i të anketuarve nuk pajtohen me këtë pretendim. Është interesante që të anketuarit nga veriu i Kosovës pajtohen me deklaratën se ekziston një nivel i lartë i korrupsionit në PK (në përqindjen prej 41.3), ndërsa kjo përqindje në jug është 36.


**Grafiku 8.** PK ka përmirësuar sigurinë e serbëve në Kosovë



Anketa e realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Në Grafikon 8 shihet se shumica e të anketuarve nuk pajtohen me deklaratën se PK-ja ka përmirësuar sigurinë e serbëve në Kosovë. 20.6% e të anketuarve nuk pajtohen aspak me këtë deklaratë, ndërsa 45.4% nuk pajtohen. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 16.2% nuk kanë një mendim të përcaktuar, ndërsa 14% pajtohen me këtë deklaratë, dhe 2.2% e të anketuarve pajtohen plotësisht; 0.7% e të anketuarve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

**Grafiku 9.** PK është e përfshirë në aktivitete kriminale




Anketa e realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Siç tregohet në Grafikon 9, mendimi i shumicës së komunitetit serb në Kosovë është që PK-ja është e përfshirë në aktivitete kriminale. Përderisa për shumicën e qytetarëve gjyqësori dhe prokuroria e shtetit konsiderohen institucione më të korruptuara në Kosovë, komuniteti serb i Kosovës thekson PK-në si institucionin më të korruptuar në Kosovë.<sup>30</sup> Mund të shohim se vetëm 2.6% e të anketuarve plotësisht nuk pajtohen me këtë deklaratë, 17% nuk pajtohen, 14.8% nuk ka mendim, dhe 34.7% e të anketuarve pajtohen me këtë deklaratë (nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 36.5% e të anketuarve e kanë këtë qëndrim në jug dhe 32.7% në veri) dhe 17.4% pajtohen plotësisht. Është fakt interesant që 13.6% e të anketuarve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje, 8% në jug dhe 26.7% në veri të Kosovës. Ky ndryshim përsëri mund të ndërlidhet me pretendimet e Komisionit Evropian sa i përket sfidave në veri të Kosovës që përfshijnë lirinë e shprehjes.<sup>31</sup>

30 P.A. (2019). Barometri Kosovari i Sigurisë, Edicion Special - Korrupsioni, Sundimi i ligjit dhe Integriteti Policor në Kosovë. I qasshëm në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Corruption\\_Rule\\_of\\_Law\\_ENG\\_Final\\_320893.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Corruption_Rule_of_Law_ENG_Final_320893.pdf)

31 <https://europeanwesternbalkans.com/2020/10/06/key-findings-of-the-2020-european-commission-report-on-kosovo/>


**Grafiku 10.** KP ne doprinosi izgradnji poverenja između Srba i Albanaca (ili kosovskih institucija)



Anketa e realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Në grafikun e paraqitur shihet se të anketuarit pajtohen me deklaratën se PK nuk kontribuon në ndërtimin e besimit midis serbëve dhe shqiptarëve (ose institucioneve të Kosovës); 37,8% e të anketuarve pajtohen, 13,7% pajtohen plotësisht, 17,5% nuk kanë mendim, 24,2% nuk pajtohen dhe 5,5% nuk pajtohen fare me këtë deklaratë; 1,2% e të anketuarve nuk u përgjigjën. Një nga arsyet mund të jetë mungesa e njohjes së gjuhës ose mungesa e përkthyesve cilësorë në strukturat e policisë që do të lehtësonin komunikimin midis dy grupeve etnike.


**Grafiku 11.** Da se nađem u nekom bezbednosnom problemu, pozvao bih KP da mi pomogne



Anketa e realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Përkundër mosbesimit të shprehur në PK, numri më i madh i të anketuarve (40.9%) pajtohen me deklaratën se nëse e gjejnë veten në një problem të sigurisë, do i telefononin PK-së për ndihmë, ndërsa 11.5% e tyre pajtohen plotësisht. Duhet të merret parasysh se PK është në fakt organizata e vetme me të cilën qytetarët nëse e gjejnë veten në një problem sigurie mund të kontaktojnë drejtpërdrejt në çdo kohë brenda 24 orësh. 16.8% e të anketuarve nuk u pajtuan me këtë deklaratë, ndërsa 11.9% nuk u pajtuan me deklaratën, dhe 2.1% nuk iu përgjigjën pyetjes. Përqindjet e përgjigjeve në këtë pyetje sipas vendbanimit, gjinisë dhe moshës së të anketuarve kanë afërsisht të njëjtat vlera.

**Grafiku 12.** PK po bën një punë të mirë në mbrojtjen e manastireve serbe




Anketa e realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Siç mund të shihet nga Grafiku 12, 22.5% e të anketuarve nuk pajtohen aspak me deklaratën se PK po bën një punë të mirë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e manastireve serbe, 25.6% nuk pajtohen, 17.4% nuk kanë qëndrim, 23% pajtohen, 9.6% pajtohen plotësisht, dhe 1.9% nuk iu përgjigjën pyetjes. Mendime mjaft të ndara të të anketuarve për cilësinë e mbrojtjes së manastireve serbe në Kosovë mund të dëgjohen në bazë të vendbanimit ku 28.7% e të anketuarve në jug të Kosovës nuk pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa me këtë deklaratë në veri të Kosovës nuk pajtohen 17.3%. Supozimi i bazuar në këtë rezultat është se banorët e komunave me shumicë serbe në jug janë më afër problemeve me të cilat përballen manastirët serbe në Kosovë, duke pasur parasysh faktin se shumica e manastireve ndodhen në jug të Kosovës. Kthimi i ushtarëve italianë të KFOR-it për sigurimin e manastirit të Deçanit<sup>32</sup> ka lëkundur në mënyrë të konsiderueshme besimin në PK kur bëhet fjalë për cilësinë e sigurisë së manastireve serbe në Kosovë.

32 <https://kossev.info/italian-kfor-soldiers-take-guard-duty-over-the-monastery-of-visoki-decani-again/>

Grupi tjetër i pretendimeve i referohet mënyrës se si Qeveria e Kosovës u soll në situatën e pandemisë së koronavirusit. Detyra e të anketuarve ishte të vlerësonin në një shkallë prej 1 deri në 5 se sa pajtohen me pretendimet e dhëna. Rezultatet janë paraqitur në Grafikon 13.

**Grafiku 13.** Sa pajtoheni me qëndrimet e mëposhtme?



Pa përgjigje
  Plotësisht pajtohem
  Pajtohem
  As pajtohem, as nuk pajtohem
  Nuk pajtohem
  Nuk pajtohem aspak

Anketa e realizuar në kuadër të iniciativës OPEN

Numri më i madh i të anketuarve pajtohet (40.5%) se ekzistenca e udhëzimeve të dyfishta nga Prishtina dhe Beogradi shkaktoi konfuzion në lidhje me udhëzimet që duhen ndjekur, ndërsa 33.8% e tyre plotësisht pajtohen me këtë deklaratë, 10.3% nuk kanë mendim, 9,1% nuk pajtohen dhe 4.3% nuk pajtohen fare, ndërsa 1.9% nuk iu përgjigjën pyetjes. Është e qartë se ky efekt është rezultat i faktit se shumica dërrmuese e serbëve në Kosovë informohen përmes mediave nga Republika e Serbisë, e cila publikoi masa të vlefshme në Republikën e Serbisë. Duhet të theksohet se masat ishin zakonisht të së njëjtës natyrë ose të ngjashme, dhe se ndryshimet kishin të bënin kryesisht me kohën e kufizimit të lëvizjes dhe punës së objekteve.

Lidhur me informacionin e ofruar në gjuhën serbe për situatën rreth pandemisë Covid-19 në komunitetin serb, 34.7% e të anketuarve pajtohen, 4.5% e të anketuarve pajtohen plotësisht, 10.7% e tyre nuk kanë mendim, 29% e të anketuarve nuk pajtohen, 18 % e tyre nuk pajtohen aspak, dhe 2.4% e tyre nuk iu përgjigjën pyetjes. Këtu duhet të theksohet se disa OJQ në fillim të pandemisë dërguan deklaratat në lidhje me mos përdorimin e gjuhës serbe për informimin e qytetarëve.


27% e të anketuarve pajtohen se Qeveria e Kosovës ka marrë të gjitha masat për të parandaluar pasojat e përhapjes së virusit Covid-19 në komunitetin serb, 6.5% e tyre plotësisht pajtohen, 14.3% nuk kanë mendim për këtë. Gjithsej 32.1% e të anketuarve nuk pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa 16.2% e tyre nuk pajtohen aspak, dhe 3.1% nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje. Këto rezultate pjesërisht janë pasojë e faktit se shumë njerëz që aplikuan për ndihmë të ofruar nga qeveria e Kosovës për të papunët nuk pranuan ndihmë, as shpjegim pse u ishte refuzuar.

30.6% e të anketuarve pajtohen me deklaratën se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë diskriminim mbi baza etnike gjatë luftës kundër Covid-19, ndërsa 6.4% e tyre plotësisht pajtohen. 17.4% e tyre nuk kanë ndonjë mendim për të, 26.3% nuk pajtohen dhe 16.2% nuk pajtohen aspak me këtë deklaratë; 3.3% e të anketuarve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

Siç mund të shihet nga grafiku, komuniteti serb ka një qëndrim mjaft tolerant ndaj shqiptarëve, në kuptimin që t'i ketë bashkëqytetarë ose zyrtarë publikë, ose si miq, fqinjë, eprorë apo kolegë në punë, të ndaj vakt me pjesëtarët e komunitetit shqiptar ose të marrë pjesë në aktivitete sportive me ta. Në këto kategori, qëndrimet mbizotëruese janë ndjenja e këndshme ose indiferenca, e cila nuk nënkupton as ndjenja të këndshme dhe as të pakëndshme. Por kur bëhet fjalë për martesën me pjesëtarët e komunitetit shqiptar, një shumicë e madhe prej 62.3% do të ndiheshin shumë të pakëndshëm ndërsa 20% do të ndiheshin të pakëndshëm, duke përbërë mbi 80% të atyre që nuk do ta shihnin një martesë të tillë në mënyrë të favorshme. Si një nga treguesit e të jetuarit së bashku, martesat e përziera midis serbëve dhe shqiptarëve nuk kanë qenë kurrë të pranueshme nga shoqëria dhe asnjëherë nuk kanë qenë në një përqindje të madhe.<sup>33</sup> Fakti se në vitet pas konfliktit në Kosovë, numri i martesave të përziera etnike midis serbëve dhe shqiptarëve është rritur ndjeshëm, ku kryeson zona e Zubin Potokut<sup>34</sup>, mirëpo duhet theksuar këtu që, si rregull, vajzat shqiptare nga Shqipëria martohen me serbë, dhe se rastet kur njëri nga bashkëshortët e etnive të ndryshme është nga Kosova, janë pothuajse inekzistente dhe maten në promilë. Ky qëndrim tregon qartë se komuniteti serb është i gatshëm për bashkëjetesë, por që jeta e përbashkët e këtyre dy komuniteteve është akoma larg.

33 Martesa të përziera etnike në Jugosllavi - Ruzha Petroviq  
34 <https://www.info-ks.net/vijesti/kosovo/38975/mjesoviti-brakovi-na-kosovu>

**Grafiku 14.** A do të ndiheshit rehat, nëse dikush që është shqiptar



Pa përgjigje
  Plotësisht pajtohem
  Pajtohem
  As pajtohem, as nuk pajtohem
  Nuk pajtohem
  Nuk pajtohem aspak

## 5. Rekomandime

- Drejtoria e Policisë së Kosovës duhet të vlerësojë nevojat teknike të stacioneve të caktuara të policisë, veçanërisht ato në veri të Kosovës dhe në Shtërpcë, kryesisht kur janë në pyetje vetura terreni dhe pajisje kompjuterike.
- Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë u rekomandohet të bashkëpunojnë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthimi për një mekanizëm me qëllim të sigurimit të kthimit të qëndrueshëm dhe eliminimit të kërcënimeve të sulmeve ndaj të kthyerve dhe pronës së tyre.
- Policia e Kosovës duhet të rrisë numrin e përkthyesve në Drejtorinë Rajonale të Mitrovicës së Veriut, si dhe në stacionet lokale të policisë në veri të Kosovës. Policisë së Kosovës i rekomandohet të rrisë numrin e përkthyesve edhe në stacione të tjera policore.
- Policia e Kosovës rekomandohet të zvogëlojë praninë fizike në pjesë të caktuara të komunave, dhe nga ana tjetër të rrisë kontaktet me popullatën, që do të kontribuojë në rritjen e besimit të komunitetit në institucion.
- Ministria e Punëve të Brendshme rekomandohet të hartojë dhe zbatojë një fushatë për të rritur numrin e grave pjesëtare të Policisë së Kosovës.
- Inspektoratit Policor të Kosovës i rekomandohet të rrisë praninë e tij, veçanërisht në veri të Kosovës, për të njohur qytetarët me institucionin e IPK-së dhe mekanizmat mbrojtës që ofron, dhe për të promovuar punën e tij, si në veri ashtu edhe në komunat e tjera me shumicë serbe në Kosovë.
- Policia e Kosovës në nivelin lokal, rajonal dhe qendror rekomandohet të organizojë takime dhe aktivitete të rregullta me komunitetin serb të Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që përmes bisedave të përmirësojë sigurinë në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës rekomandohet të gjejë mënyra për të ndërhyrë në aspektin e ofrimit të ndihmës gjatë pandemisë që do të zvogëlojë rrezikun e përhapjes së saj, domethënë të gjejë burime materiale dhe njerëzore që do të zvogëlojnë turmat dhe si rrjedhojë të zvogëlojnë rrezikun e përhapjes së sëmundjes.
- Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës duhet të pajisë stacionet lokale të policisë me materialin e nevojshëm mbrojtës, maska dhe doreza gjatë pandemisë së Covid-19.



## 6. Bibliografia

### Grupet e fokusit dhe intervistat

- Grupi i fokusit me komunitetin në Zubin Potok - 26/8/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Zveçan - 14/07/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Leposaviq - 15/07/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Graçanicë - 24/06/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Mitrovicën e Veriut - 05/08/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Shtërpçë - 11/08/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Ranillug - 20/08/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Novobërdë - 24/09/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Kllokot - 29/09/2020
- Grupi i fokusit me komunitetin në Partesh - 07/09/2020
- Intervista ballë për ballë me Rashit Qalaj, Drejtor i Policisë së Kosovës. 19/05/2020
- Intervista ballë për ballë me komandantin e Stacionit të Policisë, Predrag Vasoviq nga Leposaviqi. 17/09/2020
- Intervista ballë për ballë me komandantin e Stacionit të Policisë, Goran Zhivković nga Mitrovica e Veriut. 25/09/2020
- Intervista ballë për ballë me komandantin e Stacionit të Policisë, Dragan Stefanović nga Zveçani. 19/09/2020
- Intervista ballë për ballë me komandantin e Stacionit të Policisë, Dragan Ivanović nga Shtërpça. 30/07/2020
- Intervista ballë për ballë me komandantin e Stacionit të Policisë, Lubisha Periq nga Parteshi. 16/10/2020.
- Intervista ballë për ballë me kryesuesin e Komitetit të Sigurisë, Sasha Daniq nga Graçanica. 25/06/2020
- Intervista ballë për ballë me komandantin e Stacionit të Policisë, Zvezdan Spasojeviq nga Zubin Potoku. 28/09/2020

**Literatura:**

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve - Marrëveshja e Brukselit
- Perceptimi i komunitetit serb kundrejt Policisë së Kosovës: Mike apo armike? – KCSS
- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, neni 35.
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 19.
- Ligji Nr. 03/L-182 për mbrojtjen nga dhuna në familje
- World Directory of Minorities and Indigenous Peoples - Kosovo: Serbs
- Katër vite më vonë – OSBE
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicion Special. Korrupsioni, Sundimi i ligjit dhe Integriteti Policor në Kosovë
- Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës
- Ligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës
- Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes
- Barometri Kosovar i Sigurisë 2019
- Martesa të përziera etnike në Jugosllavi - Ruzha Petroviq

## Vegëzat e artikujve dhe njoftime në media:

- <https://kossev.info/berisa-18-srba-napustilo-kbs-od-januara/>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/708-napad-no%C5%BEem-na-povratnika-u-selu-duprava-kod-istoka.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/705-u-klini-polomljeni-prozori-na-ku%C4%87i-povratnika.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/671-saop%C5%A1tenje-za-javnost-ministra-dalibora-je-vti%C4%87a-povodom-obijanja-pravoslavne-crkve-u-babinom-most>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/615-nastavljaju-se-incidenti-na-srbe-povratnike.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/589-kontinuirani-napapadi-na-povratnike-u-istoku-i-klini-pogor%C5%A1ali-bezbednosnu-situaciju.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/588-reakcija-povodom-pretnje-smr%C4%87u-povratniku-iz-kline.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/587-zapaljena-povratni%C4%8Dka-ku%C4%87a-u-berkovu-kod-kline.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/578-srspka-%C5%A1kola-u-gojbulji-kod-vu%C4%8Ditr-na-na-meti-vandala.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/577-obilazak-uznemirenih-srba-u-cernici.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/574-cernica-na-udaru-paliku%C4%87a.html>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/519-sop%C5%A1tenje-za-medije-ministra-dalibora-je-vti%C4%87a-povodom-najnovijeg-obijanja-ku%C4%87a-10-povratni%C4%8Dkih-podica>
- <http://mzp-rks.org/sr-l/aktuelno/item/514-ministar-dalibor-jevti%C4%87-osu%C4%91uje-prebijanja-dejana-%C4%91oki%C4%87a-iz-sela-grizime-u-kamenici-od-strane-kom%C5%A1ije-albanca.html>
- <https://www.info-ks.net/vijesti/kosovo/38975/mjesoviti-brakovi-na-kosovu>
- <https://www.info-ks.net/vijesti/kosovo/38975/mjesoviti-brakovi-na-kosovu>

# Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikave publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

**Mediat** Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinionëve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

**Shoqëria civile** Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

**Partitë politike** Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**

**Përgjegjësia e institucioneve** Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

**Siguria** Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

**Ekonomia** Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

**Të drejtat e pakicave** Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**

**Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve**

**Kosovë-Serbi -** Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.



Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

